



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.17, datë 9.10.2019

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODER
DHE PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I GODINAVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE PËR STREHIM SOCIAL (NDËRTIM I RI,
GODINA SOCIALE, ME KONTEINER 1+1 DHE 2+1)**

Këshilli bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 9.10.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54, germa “dh”, neni 55, pika 3 neni 24, pika 2 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat vendore”, neni 6 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, neni 73, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, VKM nr.384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pika 101, 109/k, 132 e udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”, VKB nr.82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.6381/7, datë 1.7.2019 “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2019” dhe nr.6381/10, datë 22.7.2019 “Transferim fondesh për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë,

V E N D O S I

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër, në shumën 56,354,572 lekë, me burim financimi transfertat e kushtëzuar, në programin 6190 “Strehimi”, në kuadër të zbatimit të projektit “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social. (Ndërtim i ri, godina sociale, me konteiner 1+1 dhe 2+1)”, akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me financim 2 vjeçar 2019-2020
2. Miratimin e përdorimit të Fondit Rezervë nga programi 4980 “Shpenzime të tjera”, në programin 6190 “Strehimi”, art. 231, zëri: Investime në shumën prej 14,977,671 leke, për zbatimin e projektit „Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësive të

2. Miratimin e përdorimit të Fondit Rezervë nga programi 4980 “Shpenzime të tjera“ , në programin 6190 “Strehimi“, art. 231, zëri: Investime në shumën prej 14,977,671 leke, për zbatimin e projektit „Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social. (Ndërtim i ri, godina sociale, me konteiner 1+1 dhe 2+1).

Pakësime:

lekë

Nr. programi	Programi	Zëri	Totali
4980	Shpenzime të tjera	Fond rezervë	14,977,671

Shtesa:

Nr. programi	Programi	Emertimi	Zëri	Totali
6190	Strehimi	6190.O1.A3 Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social. (Ndërtim i ri, godina sociale, me konteiner 1+1 dhe 2+1)	Investime	14,977,671

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i këshillit

Denis Lesha



KRYETARE

Brisela KADIJA



Pr. 17576 15.10.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.1142/1 prot.

Shkodër, më 15.10.2019

LËNDA: Mbi vendimin Nr.17, datë 9.10.2019 të Këshillit Bashkiak Shkoder.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 24/2, neni 54/dh, neni 55/3, ligjit Nr.68/2017 “Për financat veteqeverisjes vendore” neni 22 dhe 27, neni 45, Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 109/k, pika 132 ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetorë ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6, neni 44, ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 73 të ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”, VKM Nr.405 dt.1.06.2016 “Për miratimin e strategjisë së strehimit social 2016-2025”, VKB Shkodër nr.82 dt.20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetit afat-mesëm përfundimtarë”, VKB Shkoder nr.26 dt.18.04.2019 “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit te vitit 2018 te Bashkise Shkoder”,VKB Shkodër Nr.84 dt.20.12.2018 “Për miratimin e planit social për Bashkinë Shkodër për vitin 2018-2021”, shqyrtoi **VKB Shkodër nr.17 dt.9.10.2019** “Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër ne shumen 56.354.572 leke (sipas shkresave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise Nr.6381/7prot dt.1.07.2019 “Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2019 dhe Nr.6381/10 prot dt.22.07.2019 “Transferim fondesh për njësitë e qeverisjes vendore”) dhe përdorimin e programit 4980 në vlerën 14.977.671 leke për zbatimin e projektit fitues “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njërive të qeverisjes vendore për ndërtim social (ndërtim i godinave sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1).

Për sa trajtuar, Prefekti autorizon procedimin e mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Cesk MILLEJA

